



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **91**

Prishtinë, më 22.10.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Etem Arifi.

Munguan : Liburn Aliu, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Anëtarët e Komisionit për Buxhet.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 15.10.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Parqet Nacionale,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.10.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 15.10.2012.

Shqyrtimi i Projektligjit për parqet nacionale bashkërisht me Komisionin për Buxhet

Kryetari i Komisionit falënderoi në pjesëmarrjen e anëtarëve të Komisionit për Buxhet, së pari njoftoi për mënyrën e vendosjes për Amendamentet në Komisionin Funkcional, pastaj kërkoj sqarimet nga Komisioni për Buxhet ku janë shfaqur dilemat financiare. Ai shtoi se ky komision në rrugëtimin e tij të shqyrtimit të problemeve me këto dy parqe, ka hasur në kundërshtime të banorëve (kryesisht të Rugovës) të cilat i ka eliminuar ose arsyetuar përmes Amendamenteve të miratuara në Komision, ndërsa mospajtimin e APK ky komision do të mundohet të eliminoi përmes takimeve në vazhdim rreth Projektligjit për Pyjet e Kosovës, ku insistohet që menaxhimi i pyjeve të bëhet nga një ministri. Me këto dy Projektligje ky komision konsideron se qytetarëve do t'ju mundësohet një kontroll më i mirë i pronave të tyre dhe pyjeve publike, njëkohësisht avancimin në drejtim të ruajtjes së natyrës në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës. Kërkesën e banorëve të Rugovës për zyrën e parkut në Pejë në janarin e vitit 2013 Komisioni ka miratuar në bazë të sugjerimeve të zyrtarëve nga MMPH të cilët kanë premtuar se nuk do të ketë probleme financiare, ndërsa kërkesat e tyre të pronësisë së hershme që nga koha e mbretit, janë adresuar në Ligjet e veçanta që do të nxirren për shqyrtimin e pronës. Në vazhdim arsyetoi secilin amendament veç e veç për dy projektet.

Kryetarja Safete Hadergjonaj gjithashtu falënderoi dhe njoftoi për mbledhjen e fundit të Komisionit për Buxhet ku janë ftuar zyrtarët nga tre Ministri (MFE, MMPH dhe MB), ku Ministri Dardan Gashi ka theksuar se janë në diskutim për të tërhequr Projektligjin për shkak të problemeve financiare, megjithatë asgjë nuk kanë marr me shkrim. Për Projektligjin e Sharrit potencoi se nuk ka ndonjë problem të madh përveç asaj se duhet të potencohet nga Komisioni Funkcional që Drejtoria e këtij parku në Prizren shndërrohet në Drejtori regjionale për parkun kombëtar të Sharrit, me çka eliminohen problemet financiare. Edhe një çështje tjetër, që ka qenë problematike në Komisionin për Buxhet, është sipërfaqja e shtuar parkut ekzistues të Sharrit, ngase me këtë shtesë krijohen probleme të kufizimit të pronave private si dhe probleme tjera financiare. Në Projektligjin për Bjeshkët e Nemuna qëndron problematika e 17 të punësuarve që do të punësohen në zyrën e parkut, si dhe probleme tjera shtesë që tregojnë se nuk bënë të përkrahet financiarisht nga ky Komision ky Projektligj, ngase ka kosto të shtuar buxhetore.

Nait Hasani ndërhyri dhe potencoi se nuk është kompetencë e buxhetit të vlerësoi pronat, mirëpo reagoi **znj. Hadergjonaj** dhe shtoi se kur ato kompensohen me buxhet, ky komision ka drejt të ndërhyjë. **Naser Osmani** gjithashtu reagoi duke shtuar se Komisioni për Buxhet nuk ka vërejtje për Sharrin por në shtesën e hektarëve të sugjeruara çka krijon dilema tek pronarët. Kosova duhet ti mbroj pyjet që i ka por është edhe fakti se afër tyre ka stane të banuara për të cilat gjithashtu duhet gjetur zgjidhjen adekvate, ngase me vite të tëra kanë qenë ashtu dhe popullata ka shfrytëzuar ato kryesisht për ngrohje. Komisioni për buxhet dëshiron të ketë qartë këtë gjendje sipas matematikës së pastër, sa do ti kushtoj kjo Buxhetit të Kosovës dhe a do të mbrohet natyra jonë me këto dy ligje, përfundoi. **Afërdita Berisha** edhe pse është votuar në Komisionin Funkcional ky Projektligj, pranoi se ka rezerva për miratimin e një Ligji i cili shpallë Park Nacional një sipërfaqe të Komunës prej 57%, gjithashtu se është fjala për projektin e pa miratuar nga Asamblea Komunale. **Sali Asllanaj** gjithashtu bëri vërejtje financiare ngase këto dy Ligje do të kufizojnë pronën private dhe shumë lloj shfrytëzimesh (minerale, ujore) nga qytetarët etj. Përveç tjerash është konfuzion i vërtet deklarimi i tre ministrave : MFE thotë se nuk ka implikime, ndërsa dy tjerat (MB dhe MMPH) thojnë se ka implikime financiare. **Salih Morina** nuk kontestoj faktet e parashtruara, mirtëpo i ceku argumentet e komisionit funksional i cili komision ka pasur parasysh djegëjet e shumta të pyjeve dhe shkatërrimet e vazhdueshme të cilat duhet disi të ndalen. Ai insistoi në zgjidhje finale sipas rregullores së Kuvendit, ose të kthehet Projektligji nëse ka nevojë të bazuar ose ti drejtohet mbledhjes plenare për vendim përfundimtar. **Sevdije Lama** u bashkëngjiti brengave të shfaqura, sidomos për gjendjen financiare pas shpalljes së Ligjit kur do të nevojitet të bëhen zonimet dhe hapja e dy zyrave. **Nijazi Idrizi** tha se midis banorëve ka pasur informim të mangët për favore dhe jofavore nga parqet, gjithashtu nuk ka pasur debat adekvat me popullatën lokale, ngase fjala është për çështjen e ngrohjes së popullatës

gjatë dimrit. Problem tjetër sipas tij është se nuk janë definuar si duhet zonat (vetëm zona e 3 thuhet se është për shfrytëzim ndërsa dy tjerat nuk sqarohen), megjithatë pranoi se me miratimin e këtyre dy Ligjeve përmbushet një standard Evropian. Shtimi i 24.000 ha të Sharrit sipas tij nuk paraqet problem, përkundrazi është përprjekje pozitive ngase aty kemi bimë endemike dhe gjëra tjera të vlefshme, por problemi kryesor është se kufizohen shfrytëzimet e të mirave të natyrës. Propozoi dhe shpresoi që këto dy Ligje ta gjejnë rrugën e vet. **Latif Gashi** pyeti Komisionin Funksional çka paraqet parku nacional, çka është nacionale, çka është private, dhe kundërshtoi Amendamentin 6 të këtij komisioni ngase në tërësi komplikon çështjen. **Xhevdet Neziraj** konstatoi se edhe Komisioni Funksional pranon se ka komplikime financiare, ndaj apeloi të ndalen këto dy Projektligje ngase janë të paparashikueshme. Edhe **Hasime Krasniqi** siç tha është befasuar me joharmonizimin e qëndrimeve në mes tre ministrave, njëra kërkon tërheqjen e Ligjit, tjetra diçka tjetër dhe ashtu me radhë. **Nait Hasani** theksoi se për të gjitha këto brenga të parashtruara Komisioni Funksional ka përgjigjet adekvate dhe rikujtoi se janë ca çështje financiare të cilat MMPH ka premtuar se nuk do të janë problematike për ti përmbushur (17 të punësuar etj), ndërsa për 4000 ha që përmenden këtu, ai nuk din se ku ka dëgjuar Komisioni për Buxhet se ato janë shtesë, ngase fjala është për pishat e veçanta (Rrobulli) në malet ndërkufitare të Dragashit dhe se ato janë pronë publike e jo private. Ai citoi cifrat të cilat tregojnë dëmin e shkaktuar nga djegëjet në verën e sivjetëm, dhe shprehu mendimin e Komisionit se vetëm me shpalljen e parqeve do të ndalen dëmet në Pyjet dhe Parqet e Kosovës. Zonat e parqeve do të caktohen nga ekspertët, vazhdoi, jo nga fshatarët, p.sh. Sharri nga 22.000 ha ka vetëm 400 ha në zonën e parë, ai njëherit citoi Nenin 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës. **Latif Gashi** tha se ministri i MMPH ka premtuar se ato hektar të propozuar do të hiqen nga Sharri ndërsa Bjeshkët e Nemuna do të hiqen krejt, ngase ka probleme me komunitetin që jetojnë aty. Ai shprehu habinë si komisioni funksional është kontra vendimeve të veta.

Dikush nga deputetët : dikush këtu po mashtron.

Salih Morina sugjeroi që në takimin e radhës të ftohen dy ministrat (MB dhe MMPH) dhe të deklarohen përfundimisht para komisionit për të tërhequr Ligjin apo jo.

Kryetarja znj. Hadergjonaj përfundoj duke sugjeruar se Komisioni Funksional mund të veproj si konsideron por me rekomandimet e Komisionit për Buxhet se ka paqartësi financiare në këto dy Projektligje. **Afërdita Berisha** përsëriti dilemat e lartcekura duke pyetur a është duke vepruar mirë Komisioni Funksional apo jo, ngase gjithmonë duhet të kemi parasysh çka përfitojnë qytetarët, përfundoi. Gjithashtu **Nijazi Idrizi** përsëriti mosqartësimin e zonave që do të përfshihen në parqet nacionale dhe kërkoi rregullimin e këtij problemi. **Etem Arifi** për shkak të qartësimin të problemeve të shfaqura në këtë takim, propozoi edhe një takim para se të dërgohen dy Projektligjet në leximin e dytë.

Kryetari i Komisionit Nait Hasani falënderoi në pjesmarrje duke shprehur gatishmërinë që në mbledhjen plenare të gërshetohen të gjitha çështjet relevante lidhur me këto dy Projektligje, dhe në fund të vendos Kuvendi i Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani